INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – Shtator 2026

Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit Shtator 2026 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 254 ankesa. Prej tyre 203 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, disa janë përcjellë në institucione tjera kurse 50 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale.

	Gjithsej	Për javë	Për ditë
Numri i ankesave	254	64	8.5

Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit Shtator 2026 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 50 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 6 punonjës të Policisë së Kosovës dhe ka arrestuar 2 të dyshuar.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin Shtator 2026
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	11
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	1
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	39
Rekomandime për suspendim	6
Të arrestuar	2

Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit Shtator 2026 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Vlerësimi i performancës së stacioneve policore	I rregullt	Final
Inspektimi i trajtimit dhe efektivitetit të hetimit të rasteve të vjedhjeve (Hani i Elezit)	Jashtëzakonshëm	Në proces